



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
 OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P.nr.285/2015

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE – Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, Kryetari i trupit gjykues – Gjyqtari, Sylë Lokaj, e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Binake Mulliqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.Q., e për veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së dhe veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 të KPK-së e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, PP.nr.330/2015 te dt. 01.12.2015, e duke vendos sipas propozimit me numër dhe datë të njëjtë, për pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe shqiptimin e sanksionit penal, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor verbalo-publik në prezencën e Prokurorit të Shtetit Valbona Disha - Haxhosaj, të akuzuarit dhe mbrojtës sipas detyres Av. S. A., me dt. **12.12.2016** mur dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.Q, i biri i H. dhe nënës M. e gjinis K, i lindur me, në P, me banim në rr ‘‘ A K’’ nr... -P, ii gjendjes së ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, i gjykuar me parë, tani gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

- Për shkak se :

1. Më parë e deri me datën 12.11.2015, rreth orës 14 në shtëpinë e tij në P, pa autorizim ka mbajtur dhe poseduar armë dhe atë një pushkë gjuetie prodhim i panjohur me nr. serik 172483 dhe 6 fishekë kalibër 12 mm, të cilat gjatë bastisjes nga policia i janë sekuestrua .

-me çka ka krye veprë penale , mbajtja ne pronësi, kontrolle , posedim apo shfrytëzim te pa autorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPK-së.

2.Me daten 12.11.2015, rreth orës 14 minuta , në shtëpinë e tij në P., tjetrit i shkakton lëndime te lehta trupore në atë menyr qe pasi që i dëmtuari V.R. shkon në shtëpin e të pandehurit,me qëllim të pagesës së borgjit, e me që i dëmtuari nuk ja kishte sjellë shumën që ishin marrë vesh,

fillimishtë fjalosen e pastaj i pandehuri e godet me shpullë në fëtyrtë e pastaj me një ghu e godet në pjesë të ndryshme të trupit dhe i shkakton lëndime të lehta trupore të konstatuara si në raportin mjekësorë nr.21353 dt 13.11.2015.

- me çka ka kryer veper penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 te KPK-së.

Për këtë gjykata ne kuptim te nenit 80 te KPK-së të akuzuarit i :

P e r c a k t o n :

Për veprën penale ne piken 1 te dispozitivit te aktgjykimit , dënim gjobe ne shumë prej 500 euro.

Për veprën penale ne piken 2, te dispozitivit te aktgjykimit , dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 muaj .

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 17, 21 par.2, 46, 49 par.1 pika 1.1, nenit 50, 51, 52, 53, 69, 73, 74, 75 par.1 pika 1.2 , 76 par.1 pika 1.7, e lidhur me nenin 374 par 1 nenit 188 par 1 dhe 2 pika 1.1 të KPK-së, dhe te nenit 365 e 366 te KPPK-së, te akuzuarin e :

G J Y K O N Ë

1.Me dënim unik - dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj

-dënim gjobe në te holla ne shumë prej pesëqindë (500) euro.

Dënimi me burg, fare nuk ka për tu ekzekutua me kushtë që i akuzuari në afatë prej një viti nuk do të kryen vepër të re penale.

Dënimi me gjobë, duhet te ekzekutohet ne afatë prej 15 ditësh , e nëse i akuzuari refuzon ekzekutimin, i njëjti dënim zëvendësohet me burgim , duke llogaritur nga 20 euro për çdo dite burgu.

2. Dënim plotësues , konfiskimi i armës, një pushkë gjuetie prodhim i panjohur me nr. serik 172483 dhe 6 fishekë kalibër 12 mm, të cilat pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi kanë për tu asgjësua.

I akuzuari detyrohet qe gjykatës ne emër te paushallit gjyqësorë të ja paguaj shumën prej 25 euro.

I dëmtuari Valmir Rama, për realizimin e kërkesës eventuale për dëmshpërblim, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh , pasi qe aktgjykimi të merre formën e prere.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore - Departamenti për Krime të Renda në Pejë, ka ngrit aktakuzë, PP.nr.330/2015 te dt. 01.12.2015, kundër të akuzuarit B.Q, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të

KPK-së dhe vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 të KPK-së. Me te njëjtin aktë, Prokurori i Shtetit – Valbona Disha - Haxhosaj, e ka njoftua gjykatën se me dt.01.12.2015, me të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij kanë lidhë marrëveshje për pranimin e fajësisë. I akuzuari e ka pranua fajësinë për vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK dhe vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 të KPK-së ,duke hequr dore nga administrimi i provave të propozuara në aktakuzë, dhe ati për veprën penale në pikën I ti shqiptohet dënimi me gjobë prej 500 deri në 700 € dhe dënimi plotësues konfiskimi i armës që ka qenë objekt me kryerjen e veprës penale dhe vepër penale në pikën II , ti shqiptohet dënimi i kushtëzuar burgimi prej 4-6 muaj

Gjykata sipas propozimit , e ka caktua seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Prokurori i shtetit , në seancën e mbajtur me dt.12.12.2016 ka mbete në tersi pranë akuzës kualifikimit të njëjtë juridik të veprës penale dhe pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, i ka propozua Gjykatës që marrëveshjen si të tillë ta pranoi.

Mbrojtësja e të akuzuarit Av. S. A. tha se, pas këshillave të mjaftueshme, i akuzuari te Prokurori i Shtetit , pa presion nga askush e ka pranua fajësinë për vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK dhe vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 të KPK-së, e me përfaqësuesin e aktakuzës, në prezencën e mbrojtësit është lidhë dhe nënshkrua marrëveshja për pranimin e fajësisë ashtu që i akuzuari për veprat penale për të cilat është akuzua, pa administrimin e provave në të cilat mbështetet aktakuza, ka pranua që të shpallet fajtor dhe penalisht përgjegjës dhe të gjykohet me dënim të përcaktuar si në marrëveshje. Për këtë i propozojmë Gjykatës që marrëveshjen si të tillë ta pranoi.

I akuzuari ka deklarua se me Prokurorin e shtetit më parë ka lidhë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe e ka pranua fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, me kushtet sikur në marrëveshje. Këtë e ka bër pa presion nga askush, i vetëdijshëm dhe me vullnet të plotë e pas këshillave paraprake nga mbrojtësi. Andaj qëndroi pranë asaj marrëveshje dhe kërkoi nga gjykata që të njëjtën si të tillë ta pranoi .

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjënë se Prokurori i Shtetit, pas negociimit me të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij, kanë lidhë marrëveshjen për pranimin e fajësisë, PP.nr.330/2015 te dt. 01.12.2015, me të cilën i akuzuari e ka pranua fajësinë për veprat penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK dhe vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 të KPK-së, dhe janë marrë veshë që i akuzuari për këto vepra penale të shpallet fajtor dhe të gjykohet me dënim gjobe dhe dënim plotësues të përshkruar si në marrëveshje.

Për vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së parashihet dënimi me gjobë apo me dënim burgu deri në pesë vite, si dhe konfiskimi i armës që është objekt me kryerjen e veprës penale dhe vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 të KPK-së parashihet dënim burgu deri në tri vite.

Nga këto fakte, Gjykata gjënë se negociimi, arritja dhe nënshkrimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë, është bër konform nenit 233 të KPPK-së.

Pas deklarimit të Prokurorit të çështjes , mbrojtësit dhe të akuzuarit, Gjykata është bindë se i akuzuari e ka kuptua natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ai këtë e ka bërë vullnetarisht pa presion nga askush e pas këshillave të mjaftueshme nga mbrojtësi, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të akuzës si dhe me dëshmitë tjera e të pranuar nga i akuzuari, e të cilat prova janë në pajtueshmëri në mes veti në pikëpamje të fakteve vendimtare, e që me asgjë nuk vihen në dyshim, e me që nuk qëndrojnë asnjë nga rrethanat për hudhjen e akuzës, paraparë me nenin 253 par.1 dhe 2 të KPPK-së. Gjykata në kuptim të nenit 233 par.21 të KPPK-së e ka pranua marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, dhe për këtë gjenë se i akuzuari ditën kohën , vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit ka krye për veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së dhe veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 të KPK-së e për këtë është fajtor dhe penalisht përgjegjës.

Para se të vendoset për dënimin, Gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, në kuptim të nenit 73 par.1 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, Gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti më parë kishte pasur sjellje korrekte dhe nuk kishin rënë asnjëherë në konflikt me ligjin, sjelljen e tij korrekte gjatë seancës së shqyrtimit të marrëveshjes dhe pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë, për veprën penale për të cilën akuzohet, premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë ato veprime, rrethana këto që Gjykata i ka pranua si rrethana favorizuese për te. Andaj në prezencën e këtyre rrethanave lehtësuese, dhe në mungesë të ndonjë rrethane rënduese, Gjykata e ka pranua edhe dënimin minimal sipas marrëveshjes, të gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kështu me bindje se edhe një dënim i tillë është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, e që edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi në pengimin e të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen që do të ndikoj edhe si preventive gjenerale për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, e në kuptim të nenit 41 të KPRK-se .

Vendimin mbi dënimin plotësues, konfiskimi i armës që ka qenë objekt me kryerjen e veprës penale është marrë konform nenit 62 dhe 69. KPK-së

Vendimi mbi shpenzimet në formë paushalli është i bazuar në nenin 450 par 2 pika 2.6 të KPPRK-se, dhe është vendosur në lartësi si në dispozitiv me bindje se i akuzuari i ka kushtet për përmbarim.

Vendimi që i dëmtuari për realizimin e kërkesave eventuale për dëmshpërblim, të udhëzohen në kontest të rregullt civil, është i bazuar në nenin 463 par.3 të KPPK-së nga se të dhënat e mbledhura në këtë procedurë nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e asë të pjesshëm të dëmit eventual të shkaktuar.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 dhe neneve 233, 247, 248 të KPPK është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

U VENDOS NË GJYKATË THEMELORE- Departamenti për krime të rënda, në Pejë me dt. 12.12.2016.

P.nr. 285/2015

Sekretarja Juridike:

Kryetari i Trupit Gjykes-Gjyqtari

Binake Mulliqi

Sylë Lokaj

UDHZIM JURIDIK

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate